



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 34/2 Prot.

Tiranë, më 19.01.2026

V E N D I M

Nr. 12, datë 19.01.2026

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 09 Regj., datë 07.01.2026, të z. A. S, kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “moshës”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar ankesës së depozituar pranë KMD-së, tek shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar, subjekti ankues, A. S, i moshës 72 (shtatëdhjetë e dy) vjeç³ pretendon se është diskriminuar nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Durrës.

Lidhur me pretendimin për diskriminim nga ana e DRSSH Durrës, ankuesi shpjegon si më poshtë vijon:

“Prej vitesh kam mbushur moshën për të dalë në pension dhe nuk marr pension. Prej vitesh përballem me institucione që nuk e kuptoj nëse e kanë me mua personalisht apo me pensionistët në përgjithësi.

I jam drejtuar DRSSH Durrës më kërkesë për caktim pensioni, me nr. 4439/6, datë 26.06.2020.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Me datëlindje 26.04.1953.

DRSSH Durrës më ka kthyer një përgjigje negative ku përmenden shumë problematika, si: mungesa e borderove, librave të pagës si dhe të dhëna të shkruara me laps plumbi në regjistrat e Arkivës së Sigurimeve Shoqërore.

Unë kam ndjekur ankimin administrativ, i cili ka zgjatur mbi një vit, pasi institucionet shtetërore nuk më kthenin përgjigje lidhur me vendimmarrjen e tyre.

Më datë 02.09.2024 i jam drejtuar me kërkesë-padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, gjykim i cili ende nuk ka filluar.

Ndërkohë, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7/2025 “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore, për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, si dhe të Rregullores së Posaçme, për zbatimin e këtij Ligji, ndodhesha në pritje të gjykimit nga Gjykata.

Në zbatim të dispozitave respektive të akteve sipërcituar, do të duhej që mua të më ishte lidhur pensioni, pasi unë nuk kam përfutur fare pension (ndërkohë që kërkesë-padinë e kam depozituar në Gjykatë në vitin 2024).

Pasi ka dalë ky ligj, me datë 30.09.2025, i jam drejtuar Portalit të Bashkëqeverisjes, i cili shqetësimin tim ia ka përcjellë organit publik ISSH-së.

ISHS, në e-mailin e dërguar nuk ka referuar kërkesën time për lidhjen e pensionit, por ka dhënë të njëjtën përgjigje si më parë, duke refuzuar sërish zbatimin e akteve të mësipërme, për lidhjen e pensionit, që nga data e depozitimit të kërkesës sime, siç e përcakton dhe dispozita ligjore përkatëse.

Në zbatimin e legjislacionit sipërcituar (ligjit nr. 7/2025 “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore, për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, si dhe të Rregullores së Posaçme), ISSH dhe DRSSH Durrës, kanë ndjekur dy sstandarde, pasi në raste të tjera të ngjashme, DRSSH Durrës është tërhequr nga gjykimi duke i sjellë Gjykatës përgjatë procesit të gjykimit, për ato çështje që nuk ishin mbyllur ende, vendimin e lidhjes së pensionit, dhe Gjykata më pas, ka disponuar pushimin e çështjes kryesisht apo me kërkesë të avokatit, pasi padia nuk qëndronte më, për shkak se paditësve u ishte lidhur pensioni.

Kështu, citoj rastet e B. L, lindur më datë 05.09.1959 (grua-mosha 66 vjeç) dhe L. A, grua në pension. Në këto dy raste, këtyre shtetaseve u është lidhur apo rishikuar pensioni i pleqërisë dhe fillimi i llogaritjes së tij është bërë nga depozitimi i kërkesës për pension, duke u rishikuar masën aktuale si dhe duke u dhënë të gjitha diferencat e pensionit të pa dhënë.

Çështja ime është e njëjtë me rastet e dy zonjave sipërcituar, por zbatimi është i ndryshëm, pasi për mua gjyqi vazhdon dhe nuk dihet se kur dhe si do të përfundojë, ndërsa për të tjerët ka përfunduar dhe gëzojnë pensionin e pleqërisë sipas periudhave të njohura në bazë të ligjit nr. 7/2025 “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore, për efekt pensioni

në sistemin e sigurimeve shoqërore”, nga lindja e të drejtës për pension, pra, i është lidhur shumë kohë para daljes së Ligjit.”

Ankuesi kërkon nga Komisioneri: *“T’i lidhet pensioni i pleqërisë, duke filluar nga data 26.06.2020, duke i njohur të gjitha periudhat sipas kërkesës dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2025 “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore, për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, si dhe të Rregullores së Posaçme, për zbatimin e këtij Ligji, duke i dhënë të gjitha shtesat kreditore dhe shpërblimet ndër vite”.*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7 të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, konstatohet se:

- Me kërkesën me nr. 5046800000 regj., datë 26.06.2020, z. A. S ka paraqitur në Degën e Përfitimeve/ALSSH Durrës kërkesë për përfitimin e pensionit të pleqërisë.
- Me Vendimin nr. 774 prot., datë 20.07.2020, Dega e Përfitimeve, pas shqyrtimit të dokumentacionit i ka kthyer përgjigje negative ankuesit.
- Duke mos qenë dakord me këtë vendim, z. S i është drejtuar Komisionit Rajonal të Ankimit, pranë DRSSH Durrës, duke e kundërshtuar atë.
- Me Vendimin nr. 194, datë 23.11.2022, Komisioni Rajonal të Ankimit, pranë DRSSH Durrës, ka rrëzuar kërkesën e z. A. S.

- Ankuesi ka kundërshtuar Vendimin e Komisionit Rajonal të Ankimimit pranë DRSSH Durrës, në Komisionin Qendror të Ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISHSH), i cili, nëpërmjet Vendimit nr. 328, datë 03.05.2024, pasi ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit, ka vendosur të mos shqyrtojë kërkesën e z. A. S dhe të lërë në fuqi Vendimin e DRSSH Durrës.
- Subjekti ankues ka ndjekur ankimimin gjyqësor kundrejt aktit administrativ të Komisionit Qendror të Ankimit pranë ISSH, dhe aktualisht vijon me procesin gjyqësor.

Në nenin 86 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, lidhur me të drejtën e ankimimit, parashikohet se:

“ 1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; Ankimi në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel;

2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar.....”.

Për sa më sipër, rezulton se pretendimi i ankuesit për mospërfitimin e pensionit të pleqërisë nga ana e subjektit ndaj të cilit është ankuar (DRSSH Durrës), pas shterimit të ankimimit administrativ, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtyre organeve (Dega Përfitimeve, DRSSH Durrës, Komisioneve Rajonale të Ankimit, pranë DRSSH apo Komisioneve Qendrore të Ankimit, pranë ISSH) nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴. Komisioneri vlerëson se ky është një pretendim që trajtohet nga organet gjyqësore dhe jo nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të moshës, nga ana e DRSSH Durrës, sa i takon mospërfitimit të pensionit të pleqërisë, Komisioneri vëren se:

Në ankesën e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është pretenduar se trajtimi i tij i pabarabartë apo i pafavorshëm nga DRSSH Durrës, ka ardhur për shkak të moshës së tij. Subjekti ankues, në rastin në fjalë ka pretenduar se nuk është përfitues i pensionit të pleqërisë, pavarësisht se gëzon moshën e pensionit, aktualisht është 73 vjeç.

⁴ Pavarësisht nëse i referohen periudhës para apo pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7/2025 *“Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në sih-kooperativat bujqësore, për efekt pensiooni në sistemin e sigurimeve shoqërore”*.

Së pari, dokumentimi i shkakut për të cilin pretendohet diskriminimi është thelbësor në çështjen e provimit të tij, për të cilin ankuesi pretendon se ka ardhur si pasojë e posedimit të tij.

Së dyti, pasi ankuesi të ketë provuar se mbart shkakun e pretenduar, duhet që ai të sjellë indicie, fakte apo prova që të dokumentojë, se pikërisht bazuar në këtë shkak, moshën e tij, ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga DRSSH Durrës.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjektet ankues janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

Komisioneri konstaton se, në rastin në fjalë, edhe dy rastet krahasimore, të cituara nga vetë ankuesi (B. S dhe L. A) kanë të njëjtën cilësi si vetë ai, pra, kanë plotësuar moshën e daljes në pension. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, gëzimi i kësaj cilësie (shkaku ligjor për daljen në pension), nuk mund të jetë shërbyer si shkak për trajtimin e tij në mënyrë të pabarabartë e të pafavorshme krahasuar me to.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vlerëson gjithashtu, se *apriori* shkakun i pretenduar nga ankuesi, nuk mund të ketë shërbyer si shkak që mund të lidhet me trajtimin e tij të padrejtë apo të pafavorshëm, përse i takon mospërfitimit të pensionit të pleqërisë nga ana e DRSSH Durrës, pasi është pikërisht gëzimi i këtij shkak (i moshës së caktuar në ligj për daljen në pension) mbi të cilin ai përfiton pensionin e pleqërisë. Pra, e gjithë kategoria e pensionistëve, që përfitojnë pension pleqërie duhet detyrimisht ta gëzojnë këtë shkak/cilësi, të jenë të moshës të caktuar në ligj, për të përfituar atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes lidhur me këtë shkak.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se: “*Ankesa nuk pranohet nëse.....është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁵.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

⁵ Për analogji citojmë vendimin nr. 235, datë 10.12.2021 dhe vendimin nr. 239, datë 09.09.2024, të KMD-së.

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 09 Regj., datë 07.01.2026, të subjektit ankues A. S, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA